

Data 11.04.2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje materiale mjekimi delegim nga MSHMS për nevoja të Drejtorise se Sherbimit Sarande” ndarë në 2 lote me fond limit në total 6,405,641.73 (gjashte milion e katerqind e pese mije e gjashteqind e dyzet e nje presje shtatedhjete e tre) Lekë pa TVSH dhe sipas loteve:

- Lot. 1 – Materiale mjekimi të përgjithshme për nevoja spitalore me fond limit- 3,377,228.00 (tre milion e treqind e shtatedhjete e shtate mije e dyqind e njezet e tete) lekë pa TVSH;

-Lot. 2 - Materiale mjekimi konsumi dhe kirurgjikale per nevoja spitalore me fond limit- 3,028,413.73 (tre milion e njezet e tete mije e katrqind e trembedhjete presje shtatedhjete e tre) lekë pa TVSH.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Materiale mjekimi te konsumueshme 33140000-3

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Drejtoria e Sherbimit Spitalor Sarande ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kritereve të përgjithshme të kualifikimit

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Xhiroja vjetore minimale e të paktën njërit prej tre viteve të fundit financiare të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të fondit të lotit ku ofertohet / shumatorës së loteve për të cilat ofertuesi konkurren.

-Për secilin lot

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43/2c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Autoriteti Kontraktor ka konsideruar te nevojshme perfshirjen e kriterit te cituar me lart, ne menyre qe t'i shërbejë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës të mundshëm si dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Kërkesa e mësipërme është në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Bazuar në nenin 43 pika 2/c dhe pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" ku përcaktohet:

Neni 43 pika 2/c

Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit "Shërbim konsulence".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 29, te Ligjit Nr. 8438, dt. 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", I ndryshuar, ku përcaktohet: Çdo tatimpagues pergatit deklaraten vjetore te te ardhurave te tatueshme ne formen e percaktuar ne udhezimin e Ministririt te Financave ne zbatim te ketij ligji.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së lotit ku ofertohet / shumatorës së loteve për të cilat ofertuesi konkurren.

Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat si dëshmi pranohen vetëm faturat tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.

Faturat të jenë të deklaruara në organet tatimore, në përputhje me parashikimet e nenit 40, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021

-Për secilin lot

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Në bazë të VKM-se nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 55, pika 4/b ku citohet se: “Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogarit të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës”

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë origjinën e mallit dhe kompaninë prodhuese

-Për secilin lot

Argumentimi: Ky kriter vendoset me qëllim njohjen e origjinës së mallit dhe kompaninë prodhuese për të identifikuar në mënyrë të qartë atë gjatë lëvrimin të tij dhe për të pasur sigurinë që i njëjti mall i ofertuar do të lëvrohet në destinacion në përputhje me nenin 40, pika 6 dhe 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, dhe kësaj kërkesë i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses të kontratës pra të garancisë së furnizimit të mallit objekt prokurimi.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatë ISO 9001 /ose/ ekuivalent ISO 13485 “Për Sistemin e menaxhimit të cilësisë” /ose ekuivalent/ të vlefshme, për prodhuesit e artikujve të ofruar, ose në rastin kur OE ofertues nuk është prodhues të paraqesë Vetëdeklarim ku të deklarojë se furnizuesi është konform Standardeve të Cilësisë.

Vetëdeklarimi do të verifikohet në procesin e vlerësimit të dokumentacionit, dhe në rastin e shpalljes fitues, OE do të dorëzojë Certifikatën në fjalë. Certifikata te jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

-Për secilin lot

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, pika 3,4 të VKMnr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se zotërojnë Certifikatat përkatëse që i mundëson Autoritetit Kontraktor për të verifikuar dhe krijuar besimin që OE ofertues është në gjendje të realizojë punën /shërbimin në mënyrë cilësore që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

2.3.4 Ofertuesi duhet te jete i certifikuar me ISO 9001 ose ekuivalente të vlefshme, për fushën e veprimtarisë që përfshin objekti i prokurimit.

Për secilin lot

Për këtë ai duhet të paraqesë certifikatën përkatëse brenda afatit të vlefshmërisë. Certifikata te jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, pika 3,4 të VKMnr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se zotërojnë Certifikatat përkatëse që i mundëson Autoritetit Kontraktor për të verifikuar dhe krijuar besimin që OE ofertues është në gjendje të realizojë punën /shërbimin në mënyrë cilësore që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikata konformiteti CE ose CE sipas direktivës (MDD ose MDR) 93/42 EEC, të vlefshme, ose Certifikate FDA, ose ekuivalent, për artikujt e ofruar, sipas kategorizimit të tyre.

Për secilin lot

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, pika 3.4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik ”Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët

ekonomikë të dëshmojnë se Certifikatat përkatëse që i mundëson Autoritetit Kontraktor për të verifikuar dhe krijuar besimin që OE ofertues është në gjendje të realizojë punën/shërbimin në mënyrë cilësore që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqese autorizim nga kompania prodhuese /Distributor i Autorizuar per Shqiperine per kete procedure prokurimi per tregtimin e artikujve te ofruar.

Ne rastin e distributorit te autorizuar per Shqiperine te provohet lidhja me prodhuesin nepermjet dokumentacionit perkates

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar ne pikat 2 dhe 4 te nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe piken 5 te nenit 44 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ku eshte e cituar: Pika 5. *”Kur është e dukshme që një operator ekonomik e ka të pamundur të marrë etiketën specifike, të cilësuar nga autoriteti/entikontraktor ose një etiketë ekuivalente, brenda afateve kohore përkatëse, për shkaqe që nuk lidhen me atë operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon mënyra të tjera vërtetimi të përshtatshme, që mund të përfshijnë një dosje teknike nga prodhuesi, nëse operatori ekonomik në fjalë vërteton se punët, furnizimet ose shërbimet që ai duhet të ofrojë përmbushin kërkesat e etiketës specifike ose kërkesat specifike të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

Autorizimi per OE ofertues nga firma prodhuese ose nga distributor i autorizuar prej prodhuesit është një dokument i domosdoshëm për t’u paraqitur, në mënyrë që autoriteti kontraktor të sigurohet që OE ofertues është në gjendje të realizojë punën/shërbimin në mënyrë cilësore që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente dhe që vlerësohet nga ana e njësisë së prokurimit si e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim të vlefshëm të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në fushën e objektit të prokurimit. (e vlefshme vetem per OE lokalë/vendas)

Për secilin lot

*Argumentimi:*Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” pika 2 “ *Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohesh në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.”* Si dhe ne baze te VKM-se nr.285, date 19.05.2021 ”Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, neni 40 pika 5 a) *Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*

2.3.8 Kërkohen të paraqiten katalogë teknikë për të gjithë artikujt e ofruar. Në katalogë, artikujt dhe specifikimet teknike të tyre duhet të markohen me ngjyrë të ndezur sipas numrit rendor të përcaktuar në formularin e ofertës. (Katalogët duhet të ngarkohen në www.app.gov.al së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DT.

Për secilin lot

Argumentimi: Ky kriter është vendosur nga ana e Autoritetit Kontraktor me qëllim vërtetimin se operatori ekonomik i plotëson kërkesat minimale në përputhje me nenin 40, pika 6 b) të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. ku shprehet rrjedhimisht: 6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose;

2.3.9 Kërkohen të paraqiten mostra për të gjithë artikujt e ofruar. Dorëzimi i Kampioneve/ mostrave të bëhet pranë Drejtorisë së Sherbimit Spitalor Sarande, të mbyllura me ngjitëse në zarf/a ose kuti jo transparente të vulosur/a, mbi të cilin/at të shënohet: “Mos e hapni me përjashtim te rasteve kur është i pranishëm Komisioni i Vlerësimit te Ofertave të kësaj procedure prokurimi dhe jo para datës 24/04/2025, ora 10 :00

- Së bashku me mostrat ofertuesi duhet të japë edhe një shkresë të vulosur dhe firmosur ku të listohen mostrat që ndodhen në zarf/kuti.

- Në paketimin e çdo mostre duhet të evidentohet qartë origjina e mallit e cila duhet të përputhet me origjinën e deklaruar nga ofertuesi në formularin e ofertës .

Për secilin lot

Argumentimi: Ky kriter është vendosur nga ana e Autoritetit Kontraktor me qëllim vërtetimin se operatori ekonomik i plotëson kërkesat minimale në përputhje me nenin 40, pika 6 b) të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. ku shprehet rrjedhimisht: 6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

Paraqitja e mostrave i shërben autoritetit kontraktor për të gjykuar më mire mbi përmbushjen e specifikimeve teknike të kërkuara për objektet që prokurohen me qëllim që cilësia e mallit të jetë në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga AK.

2.3.10.Operatori ekonomik te paraqes nje vetedeklarim ne rast se shpallet i sukseshem ,do te beje rregjistrimin e materialeve te mjekimit per te cilat eshte shpallur i sukseshem ne Regjistrin

kombetar te pajisjeve Mjekesore prane Agjensise Kombetare te Barnave dhe Pajisjeve mjekesore ne perputhje me nenin 13 te Ligjit 89/2014 i ndryshuar me ligjin 21/2020 date 5.3.2020

Për secilin lot

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” pika 2 “ *Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.*”

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Në seksionin e specifikimeve teknike, *komisioni* vendosi të njëjtat specifikime teknike dhe sasi e kërkesa të përcaktuara nga hartuesit e specifikimeve teknike të dokumentuara sipas shkresës për përlogaritjen e fondit limit të hartuar nga grupi I punes

Specifikimete teknike te pergjithshme

Materialet e mjekimit duhet të permbushin standartet CE ose CE sipas direktivës MDD/MDR 93/42 EEC. Ato duhet të jenë të markuara CE në momentin e lëvrimit të mallit.

Afati i skadencës: Jo më të vogël se 12 muaj nga data e lëvrimit të mallit në destinacion.

Skadencia duhet të jetë e shënuar në ambalazh.

Ambalazhimi të jetë i përshtatshëm sipas llojit të mallit të shoqëruar me etiketat dhe markimin përkatës.

Ofertuesi duhet të përmbushë specifikimet teknike të materialeve mjekësore detyrimisht sipas përcaktimit të bërë në përshkrimin e mallrave në DS të kësaj procedurë prokurimi.

Lot 1 - Materiale mjekimi te pergjithshme per nevoja spitalore - MM1

1	2	3	4
Nr	Artikulli	Specifikime	Njesia
	Garza, Bende, te tjera konsumable te pergjithshme		
1	Bende 7cm x 4 m	100% pambuk absorbent, dendesia 24x20	Copë
2	Bende 10 cm x 10 m	100% pambuk absorbent, dendesia 24x20	Copë
4	Bende allcie 10cm x 2.7m	Paketimi individual plastik	Copë

5	Bende adesive 10 cm x 15 m	Cope e pathurur poroze, elastike. Ana ngjitese e mbrojtur me leter te shqiteshme	Copë
6	Bende 20 cm x 10 m	100% pambuk absorbent, dendesia 24x20	Copë
7	Bende allcie 15cm x 2.7m	Paketimi individual plastik	Copë
8	Bende 8cm x 5 m	100% pambuk absorbent, dendesia 24x20	Copë
9	Bende me parafine 10x10cm	Sterile, jo me shume se 10 cope per pako	Copë
10	Komprese sterile 5cm x 5cm	100% pamb absorbent, dendesia 24x20, 6pala; jo me shume se 5 cope/pako	Copë
11	Komprese sterile 10cm x 10cm	100% pamb absorbent, dendesia 24x20, 12pala; jo me shume se 5 cope/pako	Copë
12	Komprese sterile 10cm x 20cm	100% pamb absorbent, dendesia 24x20, 8pala; jo me shume se 5 cope/pako	Copë
13	Komprese sterile 10cm x 20cm	100% pamb absorbent, dendesia 24x20, 12pala; jo me shume se 5 cope/pako	Copë
14	Komprese sterile 10cm x 10cm	100% pamb absorbent, dendesia 24x20, 16pala; paketim individual (1 cope/pako)	Copë
15	Komprese sterile 10cm x 10cm	100% pamb absorb., dend. 24x20, 6ply; jo me shume se 5 cope /pako	Copë
18	Garze abdominale	Garze sterile, e detektueshme nga rrezet-x, 100% pambuk absorbent, me 6 pala, dimensiononi i nje pale 45x45cm, dendesia 28x28, me funde te qepura, me lak lidhes, jo me shume se 5 cope per pako	Copë
19	Garze 91 cm x 100 m	100% pambuk absorbent, dendesia 24x20	m. linear
21	Pambuk kirurgjikal	100% pambuk hidrofili, pakete 100g	Copë
22	Pulla injeksioni	Dimensionet e peraferta: 0.9 cm x 3.8 cm , me garze perthithese ne mes dhe dy anet me ngjites antialergjik	Copë
23	Leukoplast 5cm x 5m	cope 100% pambuk, ngjites me permbajtje oksid zingu	Copë
24	Leukoplast antialergjik 5cm x 5m	cope e padepertueshme mendafshi, me ngjites antialergjik	Copë
25	Vaj instrumentash	Vaj per mbrojtjen e endoskopeve dhe instrumentave kirurgjikale qe kane pjese te levizshme. Perdoret pas pastrimit dhe para procesit te sterilizimit. Shishe max. 50-100ml ose ekuivalent	Copë
Sisteme dhe doreza			
27	Sisteme infuzioni	Sistem infuzioni transparente dhe fleksibel e pershtatshme si per shisheet edhe per qeset e infuzionit, e pajisur me valvol ajrimi + filter + age , luer lock + bashkuese e gomuar ne forme "Y" ose "flashball" , me PP flow rregullator , 20 pika / 1ml , e paketuar me qese te sterilizuar .	Copë
28	Doreza ekzaminimi (ndare sipas numrit)	Josterile , me latex natyral , me puder , me permasa XS, S, M, L.	Copë
29	Doreza kirurgjikale sterile (ndare sipas numrit)	Doreza kirurgjikale me puder, latex natyral, paketuar ne zarfe letre te sterilizuar me rreze Gama ose gaz Etilen sipas normativave EN; madhesia 6.5, 7, 7.5, 8, 8.5	pale
30	Lama bisturie	Nr: 15, 20, 21, 22, 23, 24	Copë

	Materiale konsumi per respirim, aspirim, infuzion		
32	Qarqe respiratori	per respirim artificial L= 1.5 m; ID 22 mm	Copë
34	Tuba Guedel	Nr. 00, 0, 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8	Copë
36	Sonde oksigjeni adult	nazale, adult, L=1.5-2 m	Copë
37	Sonde oksigjeni pediatrike	nazale, pediatrike L=1.6+0.6 m, diam .4 mm	Copë
39	Komplet aerosoli me tub zgajtues 1.5m	maske me rezervuar per medikamente	komplet
45	Tub drenimi	silikon, rulon 20-30m, diam. 6-8mm dhe 8-10mm	meter
47	Dren torakal i drejte dhe anguluar	PVC, Ch16-Ch32 - (10 cope ch 22 ch 32) i drejtre me trokar	Copë
58	Maske per terapi CPAP	Madhesi e adoptueshme nga masa S deri ne L	Copë
72	Kateter venoz Seldinger 2-rrugeshe	me dy rruge, tip Seldinger, L=20-30cm	Copë
77	Kapese kordoni umbilikal		Copë
79	Tub ushqimi pediatrik	Ch 4, 5. Pediatrik, neonatal. Pa latex/DEHP.	Copë
80	Zhgute		Copë
81	Tuba endotrakeale pediatrike	ID 2 - 5mm, nazal/oral me balon	Copë
82	Tuba endotrakeale adult	ID 5.5mm-8.5mm, nazal/oral, me ballon	Copë
83	Kateter aspirimi pediatrik	Ch 8	Copë
85	Kateter aspirimi pediatrik me kontroll vakumi	Ch 8, 10	Copë
86	Kateter aspirimi adult me kontroll vakumi	Ch 12, 14, 16, 18.	Copë
87	Set aspirimi	Set =(kanjule 26x6mm+tub 1.8-2.5m)	set
89	Tub endotrakeal 7.5	ID 7.5 mm, nazo-oral, me ballon	Copë
90	Tub endotrakeal 8.0	ID 8.0mm, nazo-oral, me ballon	Copë
91	Maske Laringeale PVC	Maske PVC me nje perdorim. Madhesia Nr.1÷5	Copë
94	Kateter me ballon per hemoragjine pas lindjes	Set steril per nderpererjen dhe menaxhimin e hemoragjise pas lindjes. Seti : Kateter silikoni Fr 24-25 me kanal per monitorim drenimi, ballon 500-600 mL, shiringe 50/60mL, set infuzioni, valvul 2-rrugeshe	set
95	Kateter me ballon per dilatacionin e columit	Induktor dilatacioni me ballon te dyfishte 2 x 80-90mL, kateter silikoni 2/3 lumen 16-18Fr, 40-50cm, udhezues metalik; set steril.	Copë
96	Spekulum vaginal	Steril, nje perdorimesh.	Copë
	Materiale konsumi per monitorim diagnostike		
103	Leter printeri fotografike		Copë
106	3-kanale	CARDILINE - 30 rulon	Copë
107	6-12 kanale	EKG 6 KANALE CARDIOLINE ECG100L ; EKG 12 KANALE CARDIOLINE ECG200S (CARDIOLINE - 50 kuti) , EKG EDAN SE1200EXPRES ; EKG FIRSTMED EKG 300 (EDAN & FRISTMED - 50 Kuti)	Copë

110	Xhel per ECHO	Bidone 5 kg , Xhel - Trasonic / Transparent , densiteti - 1/02 gr /ml + nje pistone dhe dy shishe 250 ml boshe , per cdo kater bidona	Copë
111	Xhel per EKG	Bidon 5 kg , Elektro-Xhel / ECG , densiteti - - 1/02 gr /ml + nje pistone dhe dy shishe 250 ml boshe , per cdo kater bidona	Copë
112	Elektroda monitorimi EKG	Elektroda monitorimi njeperdorimeshe	Copë
114	Elektroda Defibrillatori	Cift elektroda per defibrilator njeperdorimeshe me konektor. Sterile. (modeli i pajisjes do te percaktohet nga autoriteti kontraktor)	set
115	Aparat tensioni	Me manometer	Copë
116	Steto-fonendoskop	Koke e sheshte	Copë
117	Ndricues oral	Me bateri;	Copë
118	Termometer	termometer pacienti	Copë
121	Set per identifikimin e nenes dhe femijes	Me dy pjese per doren e nenes dhe doren e femijes ne ngjyra te dallueshme	set
122	Gojez spirometrike		Copë
137	Sensor oksimetrie neonatal	Per monitor pacienti; set njeperdorimesh neonatal me sensor oksimetrie dhe kabllin perkates	Copë
138	Sensor oksimetrine	Per monitore pacienti. Shumeperdorimesh	Copë
139	Mansheta monitorimi TA	Per monitore pacienti. Shumeperdorimesh	Copë

Specifikimete teknike te pergjithshme

Materialet e mjekimit duhet të përmbushin standartet CE ose CE sipas direktivës MDD/MDR 93/42 EEC. Ato duhet të jenë të markuara CE në momentin e lëvrimin të mallit.

Afati i skadencës: Jo më të vogël se 12 muaj nga data e lëvrimin të mallit në destinacion.

Skadencia duhet të jetë e shënuar në ambalazh.

Ambalazhimi të jetë i përshtatshëm sipas llojit të mallit të shoqëruar me etiketat dhe markimin përkatës.

Ofertuesi duhet të përmbushë specifikimet teknike të materialeve mjekësorë detyrimisht sipas përcaktimit të bërë në përshkrimin e mallrave në DS të kësaj procedurë prokurimi.

Të respektohen specifikimet teknike të kërkuara nga shërbimet për çdo artikull.

Lot 2 - Materiale mjekimi konsumi dhe kirurgjikale per nevoja spitalore - MM2

1	2	3	4
Nr	Artikulli	Specifikime	Njesia
	Materiale mjekimi per Anestezi - reanimacion		
3	Kanjule intravenoze	18G , me valvol	Copë
4	Kanjule intravenoze	20G , me valvol	Copë
5	Kanjule intravenoze	22G , me valvol	Copë
6	Kanjule intravenoze	24G, me valvol	Copë
9	Age spinale atraumatike	Pencil point; 22G - 26G; L=7-9cm (Nr 22 - 300 cop, Nr 25 - 50 cop , Nr 26 - 400 cop)	Copë
15	Kateter Foley 2-rruge	Silikon Foley Ped-adult 2-rruge 12G-20G	Copë
20	Sonde rektale pediatrike		Copë
21	Qese urine	2000ml, me valvol	Copë
27	Gjuheza per laringoskop me kamera	Paketim steril, material polimer optik, Nr.2,3,4	Copë
31	Kateter urinar	2 rruges, 12 ch, balon 10 ml	Copë
32	Kateter urinar	2 rruges, 16 ch, balon 30 -50 ml	Copë
34	Kateter urinar	2 rruges, 18 ch, balon 30-50 ml	Copë
35	Kateter urinar	2 rruges, 14 ch, balon 30-50 ml	Copë
36	Kateter urinar	3 rruges 12-20 ch, balon 30-50 ml	Copë
38	Sfungjer Nazal pa fill, epistaksis	Me perberje polivinil acetat i hidroksilizuar, kompresim i dyfishit, pa fibra, me absorbim te larte, hemostatik dhe biokompatibel, me permasa: Gjatesi 10 cm, gjeresi 1.5 cm dhe lartesi 2.5 cm	Copë
	Shiringa, Age		
42	Shiringa 50cc	Shiringe nje perdorimeshe , sterile , me Age 20 G , 3 pjese,	Copë
43	Shiringa 20cc	Shiringe nje perdorimeshe , sterile , me Age 20 G , 3 pjese,	Copë
44	Shiringa 10cc	Shiringe nje perdorimeshe , sterile , me Age 21 G , 3 pjese,	Copë
45	Shiringa 5cc	Shiringe nje perdorimeshe , sterile , me Age 22 G , 3 pjese,	Copë
46	Shiringa 2cc	Shiringe nje perdorimeshe , sterile , me Age 23G , 3 pjese,	Copë
48	Age 18G	sterile	Copë
	Materiale nje perdorimeshe per kirurgji		

58	Perparese kirurgu sterile	Perparese kirurgu me peshe jo me pak se 55 g / cm ² , me fundin e kraheve 8 cm te thurura · me jake rrethore, me kemishe me materjal PP , e sterilizuar , me permasat L ; XL ; XXL. ngjyre jeshile ose blu	Copë
59	Perparese vizitoresh	Perparese vizitoresh me peshe jo me pake se 20 gr , me menqe elastike dhe jake rrethore	Copë
60	Maske kirurgjikale	Cope e pathurur me 3 shtresa, celuloze , poliester , fiber , koficenti i filtrimit ≥ 99 % , me pershtates per hundën dhe lidhese , dimezionet 90 mm x 180 mm , pesha 2.8 gr	Copë
61	Kapele kirurgu	Cope e pathurur me peshe jo me pak se 25 gr.m ² , me lidhese poshte qafes, pa latex.	Copë
62	Kapuc per infermjere	Cope e pathurur me peshe jo me pak se 25 gr.m ² me fund elastik , pa latex.	Copë
63	Qese per veshje kepucesh	Qese PVC, me mbyllje elastike	Copë
64	Beze kirurgjikale sterile 50x75cm	Cope e pathurur, e veshur me polietilen, joinvazive, me peshe jo me pak se 35g/m ² , me permasa 50x75cm	Copë
65	Beze kirurgjikale aktive 7.5 cm x 7.5 cm	Cope e thurur, me thithje te shpejte per plage, me perberes polyakrylate (SAP) me veshje celuloze and solucion ringer, 7.5 cm x 7.5 cm ose ekuivalent	Copë
66	Beze kirurgjikale sterile 75x90cm	Cope e pathurur, e veshur me polietilen, joinvazive, me peshe jo me pak se 35g/m ² , me permasa te copes 75x90cm	Copë
67	Beze kirurgjikal sterile me vrime 200 x 250 cm	Cope e pathurur e veshur me polietilen, jo invazive, me peshe jo me pak se 35 gr/m ² , me vrime rrethore , me diameter 10 cm , me buze adesive, me permasa te copes 200 x 250 cm	Copë
68	Beze kirurgjikale sterile me vrime 75x90cm	Cope e pathurur, e veshur me polietilen, joinvazive, me peshe jo me pak se 35g/m ² , me vrime rrethore , diameter 5 cm , me buze adesive, me permasa te copes 75x90cm	Copë
69	Beze kirurgjikale sterile me vrime (100 x 150cm)	Cope e pathurur, e veshur me polietilen, joinvazive, me peshe jo me pak se 35g/m ² , me vrime rrethore , me diameter 10 cm , me buze adesive, me permasa te copes 100 cm x 150 cm .	Copë
70	Beze me vazeline	Beze me pomade te thjeshte (vazeline te bardhe, estere acid yndyror digliceroli te karbonateve dhe bikarbonateve, dyll sintetik) e pershkueshme nga ajri dhe eksudati, me shtrese te trashë qe nuk fshihet dhe ne rast te eksudatit masiv, jo alergjike, efektive dhe per trajtim afatgjate. 7.5cm x10 cm ose ekuivalent	Copë
	Materiale qepes kirurgjikale		
	Sutura mendafshi		
73	Silk -USP 0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimeznioni i ageve 40-50	me age 1/2 rrethore	Copë
74	Silk -USP 2-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimeznioni i ageve 30-35	me age 1/2 rrethore	Copë
79	Silk -USP3-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimeznioni i ageve 20-30	age 1/2 rrethore prerese	Copë

86	Nylon- USP 4-0; Gjatesia fijos 45-50 cm; Dimensioni i ageve 14-15	Monofilament I tejdukshem, age 3/8 rrethore, reverse cutting, slip point	Copë
87	Nylon- USP 5-0; Gjatesia fijos 45-50 cm; Dimensioni i ageve 14-15	Monofilament I tejdukshem, age 3/8 rrethore, reverse cutting, slip point	Copë
	Sutura Sintetike te Absorbueshme		
94	Poliglctin ose PGA , Coated- USP 1; Gjatesia e fijos 70-90 cm; Dimensioni i ageve 40-50	me age 1/2 rrethore	Copë
95	Poliglctin ose PGA , Coated- USP 0; Gjatesia e fijos 70-90 cm; Dimensioni i ageve 40-50	me age 1/2 rrethore	Copë
96	Poliglctin ose PGA , Coated- USP 2- 0; Gjatesia e fijos 70-90 cm; Dimensioni i ageve 30-40	me age 1/2 rrethore	Copë
97	Poliglctin ose PGA , Coated- USP 3- 0; Gjatesia e fijos 70-90 cm; Dimensioni i ageve 20-30	me age 1/2 rrethore	Copë
98	Poliglctin ose PGA , Coated- USP 4- 0; Gjatesia e fijos 70-90 cm; Dimensioni i ageve 20-30	me age 1/2 rrethore	Copë
99	Poliglctin ose PGA , Coated-USP5-0, Gjatesia fijos 70-90cm; dimesnioni i ageve 17-22	me age 1/2 rrethore	Copë
100	Poliglctin ose PGA , Coated-USP6-0, Gjatesia fijos 70-90cm; dimesnioni i ageve 17-22	me age 1/2 rrethore	Copë
106	Poliglctin ose PGA , Coated me absorbim te shpejte-USP4-0, Gjatesia fijos 70-90cm; dimesnioni i ageve 20-30 mm	me age 1/2 rrethore	Copë
107	Poliglctin ose PGA , Coated me absorbim te shpejte-USP3-0, Gjatesia fijos 70-90cm; dimesnioni i ageve 20-30 mm	me age 1/2 rrethore	Copë
111	Polydioxone-USP 2-0, Gjatesia fijos 70-90cm; dimesnioni i ageve 25-35	me age 1/2 rrethore	Copë

112	Polydioxone-USP 3-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 20-30	me age 1/2 rrethore	Copë
113	Polydioxone-USP 4-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 20-30	me age 1/2 rrethore	Copë
Suture Polipropileni			
121	Polypropylene-USP1, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 40-50 mm	1/2 rrethore shpuese	Copë
122	Polypropylene-USP1, Gjatesia fijes 75-90cm; dimesnioni i ageve 40-50 mm	1/2 rrethore, cutting	Copë
125	Polypropylene-USP2-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 25-30 mm	1/2 rrethore	Copë
128	Polypropylene-USP3-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 20-30 mm	1/2 rrethore. Shpuese	Copë
131	Polypropylene-USP 5-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 17-22 mm	1/2 rrethore. Shpuese	Copë
132	Polypropylene-USP1, Gjatesia fijes 75cm; dimesnioni i ageve 30 mm	1/2 rrethore, cutting	Copë
133	Polypropylene-USP2-0, Gjatesia fijes 75cm; dimesnioni i ageve 30 mm	1/2 rrethore, cutting	Copë
Sutura PVDF			
137	Monofilament PVDF, e pa absorbueshme; USP 6/0,	0.7 metric, reverse cutting, 12mm 3/8 circle, length 45 cm	Copë
139	Monofilament Sutura PVDF, e pa absorbueshme; USP 3/0	2 metric, straight cutting, 60mm straight, length 100 cm	Copë
140	Monofilament Sutura PVDF, e pa absorbueshme; USP 6/0	0.7 metric, reverse premium cutting, 12mm 3/8 circle, length 45 cm	Copë
141	Monofilament PVDF, e pa absorbueshme; USP 4/0,	1.5 metric, reverse premium cutting, 16mm 3/8 circle, length 45 cm	Copë
142	Monofilament PVDF, e pa absorbueshme; USP 3/0,	2 metric, fineline cutting, 25mm 3/8 circle, length 45 cm	Copë

143	Monofilament Sutura PVDF, e pa absorbueshme; USP 2/0	3 metric, A-cute Taper, 25mm 1/2 circle, length 90 cm	Copë
144	Monofilament Sutura PVDF e pa absorbueshme; 2/0	3 metric, Round bodied taper, 30mm 1/2 circle, length 76 cm	Copë
	Sutura PVDF e verdhe		
	Mesh kirurgjikal per hernia-laparaskopi.		
151	Mesh e vogel	Pjeserisht e absorbueshme (90-120 dite) me perberje polipropilen dhe PGA dhe kopolakton (PP/PGACL) Fije monofilament; pesha e meshes < 30 g/m2, siperfaqja jo me pak se 150cm2	Copë
152	Mesh e madhe	Pjeserisht e absorbueshme (90-120 dite) me perberje polipropilen dhe PGA dhe kopolakton (PP/PGACL) Fije monofilament; pesha e meshes < 30 g/m2, siperfaqja jo me pak se 900cm2, porozitet > 75 mikron	Copë
	Sutura per okulistike		
	Te tjera materiale qepes kirurgjikale		
	Dezifektante Mjekesore dhe Kirurgjikale		
171	Dezinfektant instrumentash me baze Glutaraldehyde-Formaldehyde	Per dezinfektimin manual te instrumenteve kirurgjikale, perfshire endoskopet dhe fibroskopet. Te kete efekt baktericid, fungicid, tuberkulocid, antiviral (perfshire HBV/HIV) Te furnizohet si komplet me solucion e pa - aktivizuar dhe aktivizuesin per perzierjen dhe perftimin e solucionit te gatshem per perdorim. Permbajtja: min. 2% glutaraldehyde, etj. Te furnizohet si solucion i gatshem per perdorim (max 5 litra / ene). Te kete referenca perdorimi nga firmat e njohura te endoskopeve dhe fibroskopeve	litra
172	Solucion i koncentruar enzimatik	Per pastrimin e mbetjeve ne intrumentat mjekesore-kirurgjikale, vecanerisht endoskopet dhe instrumentat mjekesore dhe kirurgjikale me pjese te levizeshme dhe lumene te vegjel. Te kete baze enzimatiqe. Te furnizohet si koncentrat per tu holluar me uje ne masen 1-3% . Te jete efektiv per pune ne uje me temperature te zakonshme (~20°)	litra
174	Detergjent	Dezinfektim të shpejtë dhe të vazhdueshme të të gjitha sipërfaqeve, plane sanitare, dysheme, dhe objekteve. Dezinfektanti permban 10 % Didecildimetilammonio Cloruro dhe 2 % Isotiazolinone Magnesio Cloruro , perdoret duke u tretur 20 ml ne 1 liter uje	litra
175	Xhel shumeperdorimsh	Per desinfektimin e duarve te personelit mjekesor , Antiseptik i shpejte dhe efektiv, i gatshem për ta përdorur , pa nevojën për dorimin e ujit për shplarje. Te furnizohet ne ene 1 - 3 liter te pajisura me dozator.	litra

176	Chlorhexidine gluconate	4% chlorexidine gluconate; . Antiseptik me efekt baktericid, fungicid, antiviral . Për kirurgët per desinfektimin e duarve , larja e plotë e pacientëve përpara ndërhyrjes kirurgjikale, i gatshëm për ta përdorur	litra
177	Peroksid Hidrogjeni 3%	Peroksid hidrogjeni 3% e vëllimit . Për përdorim të te plageve te jashtëme , i gatshëm për ta përdorur	litra

Specifikimete teknike te pergjithshme

Materialet e mjekimit duhet të përmbushin standartet CE ose CE sipas direktivës MDD/MDR 93/42 EEC. Ato duhet të jenë të markuara CE në momentin e lëvrimit të mallit.

Afati i skadencës: Jo më të vogël se 12 muaj nga data e lëvrimit të mallit në destinacion.

Skadencia duhet të jetë e shënuar në ambalazh.

Ambalazhimi të jetë i përshtatshëm sipas llojit të mallit të shoqëruar me etiketat dhe markimin përkatës.

Ofertuesi duhet të përmbushë specifikimet teknike të materialeve mjekësore detyrimisht sipas përcaktimit të bërë në përshkrimin e mallrave në DS të kësaj procedurë prokurimi

Të respektohen specifikimet teknike të kërkuara nga shërbimet për çdo artikull.

Në lidhje me *kushtet e veçanta për kualifikim*, njësia bazuar në rregullat e prokurimit publik të referueshme, në raport me shumën dhe shërbimin e kërkuar përcaktoi këto kritere si minimumin e kërkuar për t'u plotësuar nga operatorët ekonomikë.

Njesia e prokurimit, referuar nenit 49 pika 3 të ligjit Nr. 162/2020 datë 23.12.2020 përcaktoi afatet e dorëzimit dhe hapjes të ofertave si me poshtë :

Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje apo hapjen e tyre :

Data:24/04/2025 Ora: 10:00

Njesia E Prokurimit